



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

**Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione**

P-nr.39/2022

Prishtinë, më 19.05.2022, në orën 12:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10.

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Albana Bytyçi, Alban Bajrami, Labinotë Murtezi, Drita Millaku, Ariana Musliu –Shoshi dhe Marigona Geci.

Munguan: Tinka Kurti, Vafije Krasniqi, Eliza Hoxha dhe Milosh Peroviq.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sultane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Celal Ilyas, Kuvendi i Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi Duda Balje, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i propozimit për t'i ftuar në vizitë zyrtare deputetët e Parlamentit të Turqisë – anëtarë të Komisionit homolog për të Drejtat e Njeriut.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i propozimit për t'i ftuar në vizitë zyrtare deputetët e Parlamentit të Turqisë – anëtarë të Komisionit homolog për të Drejtat e Njeriut

Kryetarja, njoftoi komisionin se e ka thirrur këtë mbledhje shumë shkurt për të vendosur lidhur me një ftesë, që në emër të komisionit të ftojë në vizitë zyrtare në Kuvendin e Republikës së Kosovës, delegacionin e Parlamentit të Turqisë, anëtarë të Komisionit homolog për të Drejtat e Njeriut dhe Avokatin e Popullit të Turqisë, në kuadër të bashkëpunimit dy palësh të dy komisioneve tona në fusha të caktuara.

Për realizimin e vizitës nuk janë cekur data, por pas konsultimeve përfundimtare pritet të caktohet si mundësi java e fundit e muajit maj, eventualisht java e parë e muajit qershor.

Ajo po ashtu njoftoi komisionin se në të ardhmen edhe komisioni ynë do të ketë një vizitë në Parlamentin e Turqisë, pasi që Legjislacioni i Turqisë e ka ligjin për shqyrtimin e Peticioneve dhe komisioni ynë është i interesuar për një ligj të tillë.

Të shohim se si janë praktikatat dhe se si është e rregulluar fusha e shqyrtimit të peticioneve me atë ligj në Turqi dhe çka mund të na ndihmojnë neve praktikatat nga atje.

Ajo në vazhdim njoftoi komisionin se, delegacioni nga parlamenti i Turqisë që do të ftohej për vizitë tri ditore në Kosovë, do të jetë në këtë përbërje: Leyla Sahin Usta, kryetare, Metin Gundogdu, deputet, Yalçin Topçu, deputet dhe Seref MALKOÇ – Avokat i Popullit.

Kryetarja, pas njoftimit, konstatoi se komisioni unanimitisht nxori këtë:

V E N D I M

I. Komisioni ka vendosur të ftojë në vizitë zyrtare në Kuvendin e Republikës së Kosovës, delegacionin e Komisionit homolog për të Drejtat e Njeriut të Parlamentit të Republikës së Turqisë, si vijon:

1. Znj. Leyla SAHIN USTA, kryetare;
2. Z. Metin GUNDOGDU, deputet; dhe
3. Z. Yalçin TOPÇU, deputet.

II. Të mbulohen shpenzimet e krijuara për qëndrimin dhe ushqim në hotel për anëtarët e delegacionit nga pika 1. e këtij Vendimi, nga buxheti i Kuvendit të Kosovës, sipas Kërkesës për Kryetarin e Kuvendit dhe Kryesinë e Kuvendit të Kosovës.

III. Kuvendi i Republikës së Kosovës siguron transportin për delegacionin në fjalë, nga Aeroporti i Prishtinës, gjatë qëndrimit në Kosovë dhe anasjelltas nga Prishtina deri në Aeroportin e Prishtinës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetare e komisionit,

Duda BALJE